

Prishtinë: 14.01.2008
Kodi i ZRRE-së: D_074_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenet 15 dhe 26.1 (b) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenet 3 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe
3. Aplikacionin e KORLEA INVEST A.S. për licencë për furnizim/tregti me energji elektrike, të datës 30 gusht 2007, në seancën e mbajtur më 14 janar 2008 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

I. I LËSHOHET “KORLEA INVEST A.S”-së Licenca për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

1. Kompania “KORLEA INVEST A.S” me seli në Republikën Sllovaqe me datë 30.08.2007 ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për marrjen e licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gjatë vlerësimit të parë të aplikacionit si dhe dëshmime të dërguara nga “KORLEA INVEST A.S” ka vërtetuar shumë mangësi të dëshmime të dërguara, të cilat pas kërkesës për përmirësim dhe dërgim të serishëm, aplikacioni është konsideruar i kompletuar me datë 10.10.07.
3. ZRRE me datë 13.11.2007 ka bërë vlerësimin në detaje të çdo dëshmie të dërguar dhe ka vlerësuar se aplikacioni dhe dëshmitë e dërguara janë në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregulli për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin e aplikueshëm për energjinë në Kosovë.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Naim Bejtullahu, Anëtar

Nysret Avdiu, Anëtare